



Republika e Kosovës  
*Presidenti i Republikës*

DUKE PASUR PARASYSH SE, Pavarësia e Kosovës është shpallur në mënyrë formale; dhe

DUKE PASUR PARASYSH SE, shteti ynë i ri duhet të mbështetet në parimet demokratike të përcaktuara në Kushtetutë; dhe

DUKE PASUR PARASYSH SE, kohë më parë kam emëruar një Grup Punues Kushtetues në konsultim me Kryesinë e Kuvendit dhe në bashkëpunim me miqtë tanë ndërkombëtarë; dhe

DUKE PASUR PARASYSH SE, Grupi Punues Kushtetues është ndihmuar shumë nga ekspertët e Ekipit Përgatitor të Zyrës Ndërkombëtare Civile; dhe

DUKE PASUR PARASYSH SE, Grupi Punues Kushtetues është konsultuar me dhe ka involvuar antëtarët e komunitetit Serb në këtë proces deri në masën e mundshme; dhe

DUKE PASUR PARASYSH SE, Grupi Punues Kushtetues ka punuar në mënyrë të zellshme dhe të palodhshme në përgatitjen e draftit të një Kushtetute moderne dhe demokratike për Republikën e Kosovës; dhe

DUKE PASUR PARASYSH SE, Grupi Punues Kushtetues e ka përfunduar draftin e Kushtetutës; dhe

DUKE PASUR PARASYSH SE, Grupi Punues Kushtetues duhet të shpallet zyrtarisht si Komision Kushtetues i Kosovës;

TANI, ME KËTË QËLLIM, Unë, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës, marr vendim dhe shpall Komisionin Kushtetues të Kosovës në këtë përbërje:

Hajredin Kuqi, *Kryesues*

Nekibe Kelmendi, *Zëvendës kryesuese*

Arsim Bajrami

Eqrem Kryeziu

Lirije Osmani

Fatmir Fehmiu

Kadri Kryeziu

Iljaz Ramajli

Skënder Hyseni

Bajram Latifi

Blerim Shala

Ramadan Kelmendi

Ramë Manaj

Riza Smaka

Jakup Krasniqi

Gjylieta Mushkolaj


Mahir, Yagcilar

Xhevdet Neziri

TANI, PRANDAJ, Unë deklaroj se Komisioni Kushtetues do të vazhdojë të bashkëpunojë me anëtarët e komunitetit Serb në Kosovë në mënyrë joformale me qëllim që opinionet e këtij komuniteti të merren parasysh përgjatë procesit dhe që interesat e tyre të jenë të reflektuara në këtë Kushtetutë;

PRANDAJ, ME KËTË RAST, Unë deklaroj se Draft Kushtetuta e përgatitur nga Grupi Punues Kushtetues duhet të miratohet nga Komisioni si projekt i tij dhe menjëherë t'u bëhet publik qytetarëve të Republikës së Kosovës për t'u shqyrtuar dhe komentuar nga ana e tyre. Drafti përfundimtar i Kushtetutës i dorëzohet Presidentit të Republikës së Kosovës, i cili ja përcjellë këtë draft Kuvendit të Kosovës.

Prishtinë, më 19 shkurt 2008



---

Dr. Fatmir Sejdiu  
*President i Republikës së Kosovës*